REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

**Nr.**69 **prot.** **Kamëz, më** 19.05**.2022**

**V E N D I M**

**Nr.**59 **.Datë**19/05 **2022**
**MBI**
**"MIRATIMIN E GRUPIT TË PUNËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "ECO CLEANING" SH.P.K**

**Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 19.05.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.56 Datë 18.05.2022** në mbështetje të nenit 102, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;Ligjit nr. 139/2015 "Përvetqeverisjenvendore"; Ligjit nr.125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin public privat", i ndryshuar; VKM-në nr.575, datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat", i ndryshuar; Kontratës së oncesionit/ partneritetit Publik privat nr.1107 Rep, Nr.486/2 Kol, datë 23.05.2018; Kërkesës nr. 59 prot., datë 01.04.2022, të shoqërisë "Eco Cleaning" sh.p.k, të protokolluar me tonën nr. 2750 prot., datë 04.04.2022, **Këshilli Bashkiak Kamëz";**

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e grupit të punës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Eco Cleaning" sh.p.k.
2. Ngritjen e grupit të punës me qëllim shqyrtimin e kërkesës nr. 59 prot., datë 01.04.2022, të shoqërisë "Eco Cleaning" sh.p.k, të protokulluar me tonën nr. 2750 prot., datë 04.04.2022;
3. Grupi i punës të paraqesë çdo fillim jave (Ditë e Hënë) informacion lidhur me ecurinë e punës;
4. Ngarkohen anëtarët e grupit të punës për zbatimin e këtij vendimi.
5. Pjesë integrale e këtij vendimi janë relacioni dhe urdhri nr. 408 prot., datë 04.05.2022 "Mbi ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Eco Cleaning" sh.p.k.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë.**

**Kryetar Këshilli**
**HYSEN KOLDASHI**

*Adresa: Bulevardi "Nënë Tereza", Nr. 492, Kamëz Tel: +355 47 200 177 E-mail: keshilli.bashkiak@kamza.gov.al, web: www.kamza.gov.al*